



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2021

DEKLARATË
PËR CILËSINË E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM TË QENDRËS SË
SHËRBIMEVE ARSIMORE PËR VITIN 2020

Unë e nënshkruara **Rezana Vrap**i, në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe të koordinatorit të riskut të Qendrës së Shërbimeve Arsimore, deklaroj se kam përgjegjësinë për menaxhimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të burimeve financiare dhe jo financiare të njësisë Qendra e Shërbimeve Arsimore si dhe pohoj që sistemi i kontrollit të brendshëm, i ngritur nga Titullari i MASR, mbështet arritjen e objektivave, politikave dhe qëllimeve të njësisë në përputhje me përgjegjësitë që më janë caktuar sipas Nenit 9 të Ligjit nr. 10296, "Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

Ne cilësinë e Nëpunësit Autorizues deklaroj se kam monitoruar sistemin e kontrollit të brendshëm të Qendrës së Shërbimeve Arsimore gjatë vitit raportues 2020, nëpërmjet vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit për çdo komponent të menaxhimit financiar dhe kontrollit në veçanti, bazuar në orientimet e Kapitujve II dhe III të Manualit "Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" të miratuar me Urdhër të Ministrisë të Financave, Nr.54 date 15.07.2010. Metoda që është përdorur për monitorimin e komponentëve të sistemit të kontrollit të brendshëm është bërë nëpërmjet raportit për funksionimin e sistemit të brendshëm dhe pyetësorit të vetëvlerësimit.

Deklaroj nën përgjegjësinë time se raporti bashkëlidhur kësaj deklarate pasqyron në mënyrë të besueshme efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe përfshin plan veprimin për trajtimin e mangësive të vërejtura në sistem për të garantuar përmirësimin e tij në vazhdimësi.

Raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm është raportuar tek titullar i MASR dhe është diskutuar në Grupin e Menaxhimit Strategjik.

Nënshkruar nga:

Rezana VRAP
NEPUNES AUTORIZUES
DREJTOR I PËRGJITHSHËM I QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE